

Programi i Transparencës i Bashkisë Devoll

Bashkia Devoll

Sektori I Burimeve Njerezore, Protokoll-Arkive dhe TIK

I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për Bashkinë Devoll. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. (LDI)

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Bashkia Devoll ndërton dhe rrit transparencën në punën e saj institucionale, nën garancinë e Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Bashkia Devoll do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Bashkisë Devoll, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.bashkiadevoll.al si dhe në mjediset e Zyrës me Një Ndalesë (One Stop Shop). Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afatin kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e Bashkisë Devoll, është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë dhe në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

1. Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi i Transparencës i Bashkisë Devoll janë:
2. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
3. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: Bashkia Devoll ushtron funksion publik, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e Bashkisë Devoll dhe përkatësisht: Ligji nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” dhe Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
5. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
6. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
7. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
8. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
 - i plotë;
 - i saktë;
 - i përditësuar;
 - i thjeshtë në konsultim;
 - i kuptueshëm;
 - lehtësisht i aksesueshëm;
 - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Bashkia Devoll vendos në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit www.bashkiadevoll.al dhe në mjediset e institucionit, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të Bashkisë Devoll;
- Tekstet e plota, të ligjeve, të akteve nënligjore, ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë

nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;

- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t’i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të Bashkisë Devoll, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
- Bashkia Devoll, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga Bashkia Devoll.
- Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

PROGRAMI I TRANSPARENCES

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza Ligjore	Dokumenti / Përmbajta	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik	Ligj nr. 119/2014 Neni 7/1/a/d	Vendim miratimi Struktura e bashkisë http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2016/03/Urdher-struktura-22112016.pdf http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2016/03/Buxheti-2017-pjesa-e-dyte.pdf Pagat e punonjesve http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2016/03/pagat-21122016.pdf http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2016/03/Buxheti-2017-pjesa-e-dyte.pdf	Pas miratimit nga Titullari Përditësohet pas çdo akt emërimi	Në faqen zyrtare në menunë “Transparenca -Buxheti” “Transparenca -Buxheti pjesa e dyte” “Transparenca -Buxheti” “Transparenca -Buxheti pjesa e dyte”	Titullari Keshilli I Bashkise
Vendime të Këshillit të Bashkisë; dokument politikash; dokument tjetër.	Neni 7/1/b	Buxheti http://bashkiadevoll.al/bashkia/buxheti/ http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2016/03/Buxheti-2017-pjesa-e-pare.pdf	Pas miratimit në Këshillin e Bashkisë	Në faqen zyrtare në menunë “Transparenca -Buxheti 2016” “Transparenca -Buxheti 2017/pjesa e	Bashkia Devoll

		<p>http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2016/03/Buxheti-2017-pjesa-e-dyte.pdf</p> <p>http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2016/03/Buxheti-2017-Relacion-Shpenzimet.pdf</p> <p>Paketa Fiskale</p> <p>http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2016/03/DOC220616-22062016105916.pdf</p> <p>http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2016/03/Paketa-fiskale-2017.pdf</p> <p>Buxheti afatmesem</p> <p>http://bashkiadevoll.al/bashkia/buxheti/</p> <p>http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2016/03/Misioni.pdf</p> <p>Vendimet e Keshillit</p> <p>http://bashkiadevoll.al/bashkia/keshilli-bashkiak/vendimet-e-keshillit/</p> <p>Axhenda e mbledhjeve</p> <p>http://bashkiadevoll.al/bashkia/keshilli-bashkiak/axhenda-e-mbledhjeve/</p>	<p>pare”</p> <p>“Transparenca -Buxheti 2017/pjesa e dyte”</p> <p>“Transparenca Buxheti 2017/relacion shpenzimet”</p> <p>“Transparenca -Paketa Fiskale 2016”</p> <p>“Transparenca -Paketa Fiskale 2017”</p> <p>“Transparenca -Buxheti afatmesem”</p> <p>“Transparenca -Buxheti afatmesem”</p>	
--	--	--	--	--

Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat ankimit të vendimit përkatës	Ligj nr.119/2014 Neni 7/1/c/g		Pas miratimit të Programit të transparencës	Në faqen zyrtare në menunë “Formular Online” “E drejta për informim”	Zyra me Një Ndalesë
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit	Ligj nr.119/2014 Neni 7/1/ç	Shpjeguese: Në ambientet e Zyrës me Një Ndalesë Orari: E Hënë – Premte 08. ⁰⁰ – 16. ⁰⁰ http://bashkiadevoll.al/dritare-3/	Pas miratimit të urdhrit të caktimit të Koordinatorit	Në faqen zyrtare në menunë “Transparenca -Koordinatori per te drejten e informimit”	Specialisti I kërkesave-ankesave
Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve	Neni 7/1/d	Ligj nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, I ndryshuar http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2016/09/shpallje-e-e-listes-se-verifikuar-perfundimtare.docx http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2016/03/RREGULLORE-BASHKIA-DEVOLL.pdf	Menjëherë pas perfundimit të procedurës së percaktuar në ligj Urdhër emërimi	Në faqen zyrtare në menune “Punesim” “Transparenca -Rregullore e Brendshme”	Sektori I Burimeve Njerezore, protokoll-arkive dhe TIK Sektori Juridik,I prokurimeve dhe integritimit

		http://www.vendime.al/legjislatoni-per-pushtetin-vendor/ http://bashkiadevoll.al/2018/03/06/3473/ http://bashkiadevoll.al/2018/04/04/njoftim-per-vend-te-lire-punesine-sherbimin-e-mzsh-se-siasistent-zjarrfikes/ http://bashkiadevoll.al/2018/04/20/shpallje-mbi-rezultatine-vleresimit-per-pranimine-sherbimin-e-mzsh-se/		“Transparenca -Legjislacion” “Punesim” “Punesim” “Punesim”	ne BE Sektori I Burimeve Njerezore, protokoll-arkive dhe TIK Sektori I Burimeve Njerezore, protokoll-arkive dhe TIK
Mekanizmat monitorues; Raporte auditit; Dokumentet me tregues performance	Neni 7/1/dh	Raporte monitorimi dhe auditimi	Menjëherë pas depozitimit në bashki	Në faqen zyrtare në menunë “_____”	Njësia e Auditit
Buxheti	Neni 7/1/e	http://bashkiadevoll.al/bashkia/buxheti/ http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2016/03/Buxheti-2017-pjesa-e-pare.pdf http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2016/03/Buxheti-2017-pjesa-e-dyte.pdf http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2016/03/Buxheti-2017-Relacion-Shpenzimet.pdf	Pas miratimit nga Këshilli i Bashkisë	Në faqen zyrtare në menunë “Transparenca -Buxheti 2016/2017”	Sektori I Menaxhimit Financiar Sektori I te Ardhurave dhe Licencimit

Informacion për procedurat e prokurimit	Neni 7/1/ë	p/vendime p/strategji Mendimet tuaja mbi projekt vendimet mund t'i dërgoni në adresën: http://bashkiadevoll.al/dritare-1/	Pas nënshkrimit të relacionit shoqërues	Në faqen zyrtare në menunë “Transparenca”	Bashkia Devoll Sektori Juridik, I prokurimeve dhe integritetit në BE
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të ligjit nr. 119/2014	Neni 7/1/k	Regjistri I kërkesave dhe përgjigjeve http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2018/01/REGJISTR-I-K%C3%8BRKESAVE-ANKESAVE-DHE-P%C3%8BRGJIGJEVE-VITI-2017-2.pdf http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2018/05/REGJISTR-I-K%C3%8BRKESAVE-DHE-P%C3%8BRGJIGJEVE-VITI-2018.pdf	Pas miratimit nga Titullari.	Në faqen zyrtare në menunë “Transparenca - Regjistri I Ankesave/Kërkesave” Në faqen zyrtare në menunë “Transparenca”	Bashkia Devoll Zyra e Sherbimit One Stop Shop
Informacione dhe dokumente që kërkojnë shpesh Formatin i kërkesave-ankesave	Neni 7/1/k	Moduli i kërkesave http://bashkiadevoll.al/bashkia/keshilli-bashkiak/degjesa-publike/ Formati I ankeses http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2017/04/ANKESA.pdf Formati I kërkeses për informacion http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2017/04/KERK	Pas miratimit nga Titullari. Pas çdo krijimit të vendit vacante	Në faqen zyrtare në menunë “Transparenca” Në faqen zyrtare në menunë “Transparenca”	Bashkia Devoll Keshilli I Bashkise Zyra e Sherbimit One Stop Shop

		ESE-PER-INF.pdf Formati I kthimit te pergjigjes http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2017/04/KTHIM-PERGJIGJE.pdf Formati I refuzimit te dhenies se informacionit http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2017/04/REFUZIM.pdf			
Informacione të tjera të dobishme “Informacion per Kryetarin” “Reforma Administrative-Territoriale” “Turizmi”	Neni 7/1/l	Materiale ndërgjegjësuere dhe evente http://bashkiadevoll.al/bashkia/kryetari-i-bashkise/ http://bashkiadevoll.al/bashkia/stema-dhe-flamuri/ http://bashkiadevoll.al/rreth-devollit/historia-dhe-te-dhena-geografike/ http://bashkiadevoll.al/muzeumet/ http://bashkiadevoll.al/rreth-devollit/teatri/	Pas miratimit nga Titullari	Në faqen zyrtare në menune “Transparenca -Kryetari I Bashkise” “Transparenca -Reforma Administrative-Territoriale” “Turizmi-Historia dhe te dhenat geografike” “Turizmi-Monumentet e Natyres” “Turizmi-Atraksione”	Bashkia Devoll
Mbajtja e dokumentacio	Neni 7/1/h			Në faqen zyrtare në	Sektori i Protokoll

nit nga Bashkia Devoll				menunë “ _____ ”	Arkivit
------------------------------	--	--	--	---------------------	---------

V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Bashkia Devoll vendos në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit <http://www.bashkiadevoll.al/> dhe në mjediset e Zyrës me Një Ndalesë, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “*Programi i Transparencës*”.

VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit.

Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparences.